



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSME SOCIALE DHE RINISË

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____._____.2025

Lënda: Dërgim informacioni lidhur me Kartën e Studentit

Të nderuar,

Në vijim të kërkesës suaj për informacion, dërguar me datë 18.12.2025, me Nr. Prot. 25829, lidhur me Kartën e Studentit, ju informojmë se për vitin akademik 2024–2025 procesi i pajisjes së studentëve me Kartën e Studentit nuk ka qenë objekt zbatimi, për shkak se projekti ka qenë në fazë përgatitore dhe organizative.

Po ashtu, për vitin akademik 2025–2026, procesi i pajisjes së studentëve me Kartën e Studentit ndodhet ende në fazën përfundimtare të procedurave përkatëse, të cilat përfshijnë aspektet administrative, organizative dhe marrëveshjet e bashkëpunimit.

Ju bëjmë me dije se, bazuar në planifikimet aktuale, parashikohet që Karta e Studentit të lançohet gjatë muajit janar 2026, pas përmbylljes së të gjitha procedurave të nevojshme, çka do të mundësojë më pas edhe pajisjen e studentëve përkatës.

Për çdo informacion shtesë apo sqarim të mëtejshëm, mbetemi në dispozicionin tuaj.

Duke ju falënderuar,

KRYETAR
Benet BECI